



ARMENIA

RAPORTIMI FINANCIAR PËR TRANSPARENCËN E BORXHIT DHE TË INVESTIMEVE

Seminari Rajonal me Zyrtarë Publik
të Evropës dhe Azisë Qendrore
1 dhjetor 2020

ARTUR HAMBARDZUMYAN

Shef i Sektorit të Strategjisë dhe Menaxhimit të Risqeve
, Drejtoria Menaxhimit të Borxhit Publik

- **Informacion i përgjithshëm për vendin**
- **Kuadri ligjor për menaxhimin e borxhit**
- **Statistikat e borxhit të sektorit publik**
- **Raportet dhe informacionet për borxhin e sektorit publik**
- **Nënhuatë dhe dorëzanitë nga qeverisja qendrore**
- **Këqyrja dhe kontrolli mbi borxhin e sektorit publik**
- **Çështjet kryesore që pengojnë transparencën e borxhit dhe masat për përmirësimin e saj**



Informacion i përgjithshëm për vendin



Formati i qeverisjes
Republikë parlamentare



Kreu i shtetit
Presidenti



Kryeqyteti
Jerevani



Shpallja e pavarësisë
21 shtator 1991



Territori
29.743 km²



Popullsia
2,96 miionë



Diaspora
8 milionë në mbarë botën



PBB nominale
13,7 miliardë US\$ (2019)



PBB për frymë
4.615 US\$ (2019)



Monedha
Dhrami ermen (AMD)



“Vlerësim shtetëror
Moody’s: Ba3 (e qëndrueshme)
Fitch: B+ (e qëndrueshme)



- **Legislacioni** i Republikës së Armenisë për borxhin publik konsiston në: Ligjin për Borxhin Publik, Kodin Civil të Armenisë, Ligjin për CBA-në, akte të tjera ligjore dhe traktatet ndërkombëtare të Armenisë.

Ligji për Borxhin Publik

- Qëllimi i ligjit.
- Objektivi kryesor i menaxhimit të borxhit shtetëror.
- Qëllimet për të cilat merret borxh publik.
- Struktura e borxhit publik.
- Mbulimi institucional i borxhit publik.
- Përbërësit e borxhit publik.
- Parimet e menaxhimit të borxhit

Ligji për Bankën Qendrore

- Borxhi i jashtëm i BQ-së merret në emër dhe për llogari të BQ-së.
- Përcakton objektivat e menaxhimit të borxhit të BQ-së.
- Një prej objektivave dytësorë të BQ-së është përpilimi, përmbledhja dhe publikimi i statistikave mbi borxhin publik dhe privat të jashtëm.

Statistikat e borxhit të sektorit publik 1

Kontabiliteti shtetëror është me bazë monetare në Armeni dhe mbështetet në GFSM 2001. Por, statistikat mbi borxhin e qeverisjes qendrore mbështetjen në kuadrin kombëtar.


Ministria e Financave e Armenisë përpilon të dhënat mbi borxhin e jashtëm dhe të brendshëm të nënsektorëve të qeverisjes qendrore.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtën të marrin hua sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore.

Përbërja e borxhit të përgjithshëm të qeverisë në Armeni.

Vetëm të dhënat e borxhit të jashtëm të BQA-së përfshihen në llogaritjen e borxhit publik në Armeni.

Të dhënat e borxhit të shoqërive jofinanciare nuk përfshihen në të dhënat e borxhit publik në Armeni.



DMFAS 6, si edhe tabela në Excel përdoren për regjistrimin e të dhënave të borxhit të qeverisjes qendrore. Nuk ka ndërfaqe me Sistemin e Informacionit të Menaxhimit Financiar.

Sipas legjislacionit kombëtar, detyrimet e prapambetura mbi titujt e borxhit dhe huatë, përfshirë interesat që nuk paguhen në afat, duhet të njihen në të dhënat statistikore dhe të përfshihen në stokun e borxhit.

Konsolidimi i të dhënave për borxhin publik.

Letrat me vlerë të borxhit publik vlerësohen me vlerë nominale për përpilimin e statistikave.

Të dhënat e përpiluara me statistikat e borxhit publik nxirren mbi baza mujore, tremujore dhe vjetore nga Ministria e Financave dhe publikohen në faqen në internet të MF-së.

- Buletini statistikor për borxhin publik publikohet çdo muaj dhe mbulon borxhin e brendshëm dhe të jashtëm të qeverisjes qendrore dhe dorëzanitë për hua, borxhin e jashtëm të BQA-së, si edhe huatë dhe nënhuatë buxhetore.
- Raporti tremujor për borxhin publik bën pjesë në raportin për buxhetin e shtetit, ku jepen informacione edhe për borxhin publik dhe detyrimet afatshkurtra.
- Raporti vjetor për borxhin publik mbulon borxhin e brendshëm dhe të jashtëm të qeverisjes qendrore, dorëzanitë për huatë dhe borxhin e jashtëm të BQA-së. Raportet vjetore publikohen edhe në letër.

Ministria e Financave publikon në faqen e saj në internet edhe raporte dhe informacione të tjera për borxhin.

- Raportet për rezultatet e ankandeve të obligacioneve shtetërore
- Kushtet e huave dhe kredive të jashtme të qeverisë
- Strategjia e menaxhimit të borxhit të qeverisë
- Plani vjetor i huamarrjes
- Raporte dhe informacione të tjera

Qeverisja qendrore ofron dorëzani për ndërmarrje shtetërore, institucione financiare, njësi të qeverisjes vendore

- Dorëzanitë shtetërore mund të jepen në bazë të një opinioni pozitiv të MF-së.
- Kushtet kryesore për dhënien e dorëzaneve buxhetore.
- MF ka të drejtë të këqyrë gjendjen financiare përpara shlyerjes së huasë.
- Dorëzanitë e jashtme të qeverisë që i janë lëshuar Bankës Qendrore regjistrohen si borxh i BQA-së.

Qeverisja qendrore ofron nënhua për ndërmarrje shtetërore, institucione financiare, njësi të qeverisjes vendore


- Nënhuatë nën huamarrjen e jashtme nga qeveria u janë dhënë kryesisht ndërmarrjeve shtetërore të sektorit energjetik.
- Kreditë dhe huatë e jashtme janë investuar nëpërmjet njësive të zbatimit të projekteve. Ka pasur edhe hua për mbështetje buxhetore. Teprica që mbetet të shlyhet është 4.572 milionë USD.
- Janë dhënë edhe nënhua me huamarrje të brendshme nga qeveria dhe me të ardhurat e veta të buxhetit të shtetit.



Dhoma e Auditimit e Armenisë është përgjegjëse për auditimin e jashtëm të borxhit publik në Armeni.



Auditimi i brendshëm është aktualisht shërbim i kaluar me kontratë të tretë për MF-në.



Evidencat e borxhit të qeverisjes qendrore dhe evidencat e projekteve të investimeve publike rakordohen në mënyrë periodike me burimet përkatëse të borxhit.

Problemet madhore të cilat e pengojnë transparencën mbi borxhin

- Problem madhor që pengon transparencën e borxhit është mbulimi i paplotë i borxhit të sektorit publik nga ana e legjislacionit.
- Përdorimi jo i plotë i standardeve financiare dhe kontabël.

Masat për rritjen e transparencës së borxhit

- Përmirësimi i kuadrit rregullator, si edhe zbatimi i GFSM 2014 dhe APSAS në Armeni.
- Vijimi i ngritjes së kapaciteteve të personelit me fokus te regjistrimi, raportimi dhe menaxhimi i borxhit.
- Përdorimi jo i plotë i standardeve financiare dhe kontabël.



Faleminderit!